



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE PËR PUNËSIM DHE AFTËSI
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “PETRO SOTA” FIER

Nr 553 Prot

Fier, më 19/10/2022

Lenda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dheformimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021 ”Për mënyrën e organizimit dheveprimtarisë së institucionevetë arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”:

Shkolla e mesme profesionale “Petro Sota” Fier ju njofton krijimin e vendeve te lira pune për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale:

- 1) 2 mësimdhënës të kulturës profesionale me shkollë të mesme për drejtimin:
mekanikë
- 2) 1 mësimdhënës i kulturës profesionale me shkollë të mesme ,me kohë të pjesshme për drejtimin:
nafte

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljesdhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kritere të posaçme

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin /kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së ,për të cilin/cilat po aplikon ;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

1. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) -letërmotivimin për pozicionin;
- b) -jetëshkrimin (CV-në);
- c) -kartën e identitetit;
- d) -diplomën;
- e) -Librezën e punës
- f) -çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) -certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive teknologjinë e informacionit;
- h) -vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) -vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) -vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrë sekretarisë së Shkollës së mesme profesionale “Petro Sota” Fier , brenda datës 28 / 10 /2022

DREJTORI I SHKOLLËS

Arta LEKA

